

Drejtësi

Kërkohet paraburgim ndaj dy personave në Ferizaj për shitblerje të rreth 5.5 kg narkotikëve dhe armëmbajtje pa leje



Sinjali.com

03 Shtator 2026 16:57



Prokuroria Themelore në Ferizaj ka kërkuar nga Gjykata Themelore caktimin e masës së paraburgimit ndaj dy personave të dyshuar për vepra penale që lidhen me narkotikët dhe armëmbajtjen pa leje.

Të dyshuarit janë F.D., shtetas i Shqipërisë, dhe E.D., shtetas i Kosovës.

Sipas Prokurorisë, gjatë një aksioni të zhvilluar më 2 shtator 2026 nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë në Ferizaj, është kontrolluar shtëpia e të dyshuarit F.D.

Gjatë kontrollit janë gjetur dhe konfiskuar katër kavanoza me rreth 4.9 kilogramë substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë dhe 4.6 gramë substancë të dyshuar si kokainë.

Po ashtu, janë sekuestruar një peshore digjitale, materiale për paketim, qese të zbrazëta, një pistoletë me gaz me karikator, pesë fishekë, para të gatshme në euro dhe lekë, një veturë "Passat" me targa të Shqipërisë, telefona, kartela SIM dhe sende të tjera.

Ndërkohë, gjatë kontrollit të bodrumit të një banese në rrugën "Beteja e Koshares", që dyshohet se lidhet me të pandehurin E.D., janë gjetur dhe konfiskuar 566 gramë marihuanë, si dhe disa sasi të tjera më të vogla.

Prokuroria bëri të ditur se gjatë kontrolleve janë sekuestruar gjithsej mbi 5.5 kilogramë substanca të dyshuara narkotike, përfshirë marihuanë dhe kokainë, si dhe një armë dhe municion.

Të dyshuarit po hetohen për veprat penale "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge" dhe "Mbajtja në pronësi ose kontroll i paautorizuar i armës".

F.D. dhe E.D. ndodhen nën masën e ndalimit 48-orësh që nga 2 shtatori, ndërsa Gjykata pritet të vendosë lidhur me kërkesën për paraburgim.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera